



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË UST

Nr. 625. Prot

Tiranë, më 05.04.2019

Drejtuar: **Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës**

Prof. Dr. Agron CUKA

Lënda : **Raporti i Punës për Muajin Mars i NJSBC-së pranë UST.**

R A P O R T

Gjatë muajit Mars 2019 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST (NJSBC), e përbërë nga: Prof. Dhimitraq Stratobërdha (Kryetar), Dr. Mirjeta Cenaj dhe Doc. Anduela Lile (Anëtarë) në përputhje me detyrat, që u ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me punën e NJSBC –ve pranë IAL (UST), bazuar në Plan Veprimin për vitin 2018-2019 ka vazhduar punën për të marrë informacione nga njësitë kryesore, administrata e UST dhe për programet e fakulteteve të UST.

Eshtë punuar me Manualin e ASCAL për të qenë në punën tone konform standardeve të kërkuara, në lidhje me dokumentacionin e kësaj njësie e në përputhje me ligjin e aktet e tjera nënligjore.

Kemi hyrë në fazën e dytë të vlersimeve, që është edhe më e rëndësishmja e që duhet tu përgjigjet standardeve ku do të arrijë cdo IAL.

Konkretisht nga ana jonë, gjatë Janarit, u përgatit një pyetsor për studentët e UST për të tërhequr mendimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programeve të studimit.

Pasi u përgatitën, iu shpërndanë studentëve dhe gjatë muajit Shkurt janë mbledhur pyetsoret nga gjithë programet e UST deri në fillimin e sezonit provimeve, afati kohor lënë deri dt 10.02.2019.

Pyetsoret gjatë Shkurtit vazhduan të hidhen në sistemin e përpunimit statistikor.

Gjatë muajit Mars u bë përpunimi I të dhënave të pyetsoreve dhe u përgatit një raport mbi rezultatet e përfutuara nga studentët që u janë përgjigjur këtyre pyetsorëve.

NSBC e ngritur sipas Vendimit Nr.9 dt. 02.03.2018 të Bordit të Administrimit dhe Vendimit nr.16 dt 27.02.2018 të Senatit Akademik pas hartimit të planit të punës, evidentoi mangësinë e realizimit të pyetësoreve të Studentëve dhe përgatiti një pyetësor pilot duke anketuar fillimisht student të Masterit Profesional të programit të studimit “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” në FVFR. Në vazhde të kësaj pune të nisur u zhvilluan dhe pyetësorët me studentët e cikleve të tjera të studimit në të dy fakultetet e UST-ës gjatë muajit maj 2018 dhe shkurt 2019. Ky pyetësor iu dërgua në formë elektronike të gjithë studentëve të UST, të ciklit bachelor dhe master, në adresat e deklaruara në